

VENDIM
Nr. 813, datë 26.11.2014

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.140, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PANAIRIN
NDËRKOMBËTAR “EXPO MILANO 2015””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr.140, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 7.1, me këtë përmbajtje:

“7.1 Kostoja paraprake për konceptimin dhe projektimin artistik të pavionit shqiptar, si dhe organizimin për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “Expo Milano 2015”, prej 39 000 000 (tridhjetë e nëntë milionë) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

a) 4 000 000 (katër milionë) lekë nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/AIDA;

b) pjesa tjetër të përballohet nga buxheti që do të miratohet për vitin 2015 për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama